

DEKLARATË

Autoritetet shtetërore të ngrënë zërin ndaj cënimit të të drejtave civile dhe politike të qytetarëve

Më datë 3 janar 2024 Rrjeti Global i Vëzhguesve Vendorë të Zgjedhjeve (Global Network of Domestic Election Monitors - GNDEM), publikoi një [Deklaratë](#) e cila dënon sulmet e ndodhura në Sërbi përgjatë Zgjedhjeve të parakohshme Parlamentare të dhjetorit 2023 ndaj organizatës vendore vëzhguese të zgjedhjeve “Qendra për Kërkim, Transparencë dhe Përgjegjshmëri” (Center for Research, Transparency and Accountability - CRTA), sulme të cilat konsistojnë që nga pengesat për tu informuar e vëzhguar përgatitjet e procesit zgjedhor e deri tek rastet e dhunës ndaj vëzhguesve të organizatës.

KRIIK si pjesë e këtij Rrjeti Global, si dhe e Rrjetit Europian të Organizatave Vëzhguese të Zgjedhjeve (European Network of Election Monitoring Organizations - ENEMO), mbështet fort këtë Deklaratë dhe **dënon ashpër këtë qasje anti-europiane të pushteteve autokratike ndaj organizatave vendore të vëzhgimit të zgjedhjeve**, apo edhe ndaj zërave kritikë në tërësi të shoqërisë civile.

Siç edhe deklarata e GNDEM thekson, sulmet nga zyrtarët publikë kërcënojnë aftësinë e organizatave vendore për të vëzhguar zgjedhjet.

Vëzhguesit e zgjedhjeve, ashtu siç [ka deklaruar Raportuesi Special i Kombeve të Bashkuara për Situatën e Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut](#), janë mbrojtës të të drejtave të njeriut që shërbejnë për mbrojtjen e të drejtave civile dhe politike të qytetarëve, ndaj nevojitet të e duhen trajtuar si të tillë nga autoritetet.

Bazuar në sa Deklarata sjell, **KRIIK ngre shqetësimin** se të tilla veprime, të cilat tanimë janë kthyer në praktikë në një numër vendesh me demokraci të brishtë në Europë, e më gjerë, **shënojnë hapa pas në forcimin e demokracisë dhe shtetit ligjor në rajon, Europë, e më gjerë**. Aktorët ndërkombëtarë dhe shtetet duhet të reagojnë fort dhe në kohë ndaj të tilla praktikave, duke mos lejuar që ato të kthehen në normë, duke shpënë në sulme edhe më të rënda ndaj vëzhguesve qytetarë.

Duke marrë shkas nga kjo Deklaratë, **KRIIK sjell në vëmendje të opinionit publik në vend, sidomos të aktorëve institucionalë e vendimmarrës**, se pengesat në ushtrimin e misionit të organizatave vëzhguese, të mosbërjes transparencë dhe shkeljes së vazhdueshme të ligjit, apo intimidimi në forma nga më të ndryshme, parë kjo veçanërisht nën dritën e patronazhimit masiv të ngritur në administratën shtetërore e gati në tërë shoqërinë shqiptare, **po zbeh gjithnjë e më shumë hapësirat demokratike** dhe po krijojnë premisa të lejimit, herët a vonë, në mënyrë të hapur të fenomenit të dhunës përgjatë proceseve zgjedhore.

Një situatë e tillë **kërcënon seriozisht dhe përmbajtësisht aftësinë e qytetarëve për të marrë pjesë në jetën publike të vendit**, në shkelje të nenit 21 të [Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut](#).

Në këtë kuadër, KRIIK ri-përsërit thirrjen e bërë edhe më parë ndaj Liderit të Partive Politike, Kuvendit të Shqipërisë dhe Deputetëve të tij që të marrin e zhvillojnë efektivisht përgjegjësitë e tyre në zbatim të detyrimeve kushtetuese, parimeve dhe vlerave demokratike, **duke funksionalizuar demokracinë në vend** e nisur sa më parë **procesin real e gjithëpërfshirës të Reformës Zgjedhore**. Thirrja e sotme e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve meriton të vlerësohet e merret sa më parë në konsideratë.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Në përfundim, KRIIK iu kërkon Autoriteteve Shtetërore që të reagojnë ndaj sulmeve të kryera ndaj organizatave vëzhguese të zgjedhjeve në vendin fqinj, **si një tregues i angazhimit të tyre ndaj vlerave dhe standardeve demokratike që Shqipëria aspron.**

Qeveria Shqiptare, nën përgjegjësinë e Anëtarit të Këshillit të të Drejtave të Njeriut për periudhën 2024-2026 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, **duhet të ngrejë zërin për cënimin e të drejtave civile dhe politike të qytetarëve e veçanërisht të organizatave që luftojnë për mbrojtjen dhe promovimin e tyre kudo në botë, duke marrë shkas e trajtuar edhe rastin e [Deklaratës së publikuar nga Rrjeti Global i Vëzhguesve Vendorë të Zgjedhjeve](#) për cënimin e këtyre të drejtave në zgjedhjet e dhjetorit 2023 në Serbi.**

Tiranë, më 15 Janar 2024!

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania